



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Ac.nr.1041/18

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Frosina Sylejmani, kryetare e kolegjit, Arsim Hamzaj dhe Enes Mehmeti, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson L.R. nga Prishtina, kundër të paditurit A.M. nga fshati ..., Komuna e Skenderajit, për shkak të rimbursimit të dëmit, duke vendosur sipas ankesës së paditëses, të paraqitur kundër aktgjykim të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Skenderaj-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, C.nr.323/2015, i datës 11.12.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 27.12.2019, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Skenderaj-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, C.nr.323/2015, i datës 11.12.2017, VËRTETOHET.

### A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar, C.nr.323/2015, i datës 11.12.2017, e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses Byroja Kosovare e Sigurimeve, me seli në Prishtinë dhe e ka detyruar të paditurin A.M. që paditëses të ia kompensoj shumën prej 631.50 Euro, në emër të rimbursimit të dëmit material të shkaktuar në aksidentin e trafikut më datës 27.11.2011 në ..., me kamatë ligjore sipas mjeteve të deponuara në bankat pa destinim të caktuar mbi një vit, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Pjesën tjetër të kërkesëpadisë në shumën prej 631.50 Euro e ka refuzuar si të pabazuar. Lidhur me shpenzimet ka obliguar të paditurin që paditëses të ia kompensoj shpenzimet në shumën prej 20 Euro, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi paditësja në afat ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të

gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj si të bazuar ankesën, dhe aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj duke e aprovuar në tërësi kërkesëpadinë e saj apo i njëjti të prishet dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Ankesa e paditëses i është dorëzuar të paditurit por i njëjti nuk ka dhënë përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e paditëses është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurit, me të cilën ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadija e paditëses në tërësi si e bazuar dhe të detyrohet i padituri që paditëses të ia paguaj shumën prej 2.052 Euro, në emër të rimbursimit të dëmit të shkaktuar në aksidentin e trafikut të datës 27.11.2011 në ..., me kamatë ligjore nga dita e ngritjes së kësaj padie e deri në ditën e pagesës përfundimtare, si dhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata e shkallës së parë duke vendosur sipas padisë së paditëses kundër të paditurit, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor ka marrë aktgjykimin e atakuar C.nr.323/2015, i datës 11.12.2017 me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimin të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike ka bërë administrimin e provave si raporti i aksidentit nr.2011-BR-721, i datës 27.11.2011, ujdia jashtëgjyqësore e datës 17.04.2012, urdhër transferi i mjeteve i datës 23.04.2012, vendimi i komisionit për trajtimin e dëmeve nr.168/12, i datës 29.03.2012, ekspertiza C.nr.152/14 e datës 19.03.2015 dhe C.nr.323/15 e datës 12.10.2017.

Gjykata e shkallës së parë nga administrimi i provave arriti në përfundim se padia e paditëses është pjesërisht e bazuar ngase nga raporti i aksidenti u arrit të konstatohet se me datën 27.11.2011 ka ndodhur aksidenti në fshatin ..., ndërmjetë të paditurit dhe të dëmtuarës A.A., por nga ekspertiza e ekspertit gjyqësore Ing. S. B. dhe nga eksperti Ing. Y. K. u konstatua se të dy ngasësit kanë kontribuar në shkaktimin e aksidentit në mënyrë të barabartë. Gjithashtu nga ujdia jashtë gjyqësore u konstatua se në mes të paditëses dhe të dëmtuarës A.A. është dhënë shuma prej 1.263 Euro dhe kjo është vërtetua edhe nga urdhër transferi i datës 23.04.2012. Andaj gjykata e shkallës së parë konform dispozitës ligjore përkatësisht neni 18 dhe 18 par.4 të Ligjit për sigurimet e detyrueshme nga Autopërgjegjësia, personi i dëmtuar ka të drejtë të kërkoj shpërblimin e dëmit dhe paditësja ka të drejtën e regresit nga i padituri e që në rastin konkret pasi që i padituri dhe e dëmtuara kanë kontribuar në mënyrë solidare në shkaktimin e aksidentit atëherë e njëjta është kompensuar nga paditësja, gjykata shumën e kërkuar nga paditësja e

aprovoi vetëm pjesërisht, ndërsa pjesën tjetër të kërkesëpadisë e refuzoi si të pabazuar. Lidhur me shpenzimet vendosi konform nënti 452 par.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së ka konstatuar se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje nga neni 182.2 pika b), g), j) k) dhe m) për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare dhe nuk përmban as shkelje tjera procedurale sipas pretendimeve ankimore të paditëses të parashtruara përmes ankesës.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore për gjendjen faktike, pasi që nga shkresat e lëndës konstatohet se të gjitha faktet e çështjes përveç atyre jo kontestuese janë provuar me prova përkatëse të administruara në procedurën e provave ku nga raporti i aksidenti u arrit të konstatohet se me datën 27.11.2011 ka ndodhur aksidenti në fshatin ..., ndërmjetë të paditurit dhe të dëmtuarës A.A., por nga ekspertiza e ekspertit gjyqësore Ing. S.B. dhe nga eksperti Ing. Y. K. u konstatua se të dy ngasësit kanë kontribuar në shkaktimin e aksidentit në mënyrë të barabartë. Gjithashtu nga ujdia jashtë gjyqësore u konstatua se në mes të paditëses dhe të dëmtuarës A.A. është dhënë shuma prej 1.263 Euro dhe kjo është vërtetua edhe nga urdhër transferi i datës 23.04.2012.

Gjykata e Apelit gjithashtu sipas pretendimeve ankimore dhe ex officio ka vlerësuar zbatimin e të drejtës materiale nga gjykata e shkallës së parë, duke vlerësuar se në kuptim të dispozitave materialo-juridike të cilave i është referuar gjykata e shkallës së parë në përputhje me gjendjen faktike, duke marrë në konsideratë nenit 18 dhe 18 par.4 të Ligjit për sigurimet e detyrueshme nga Autopërgjegjësia, paditësja ka të drejtën e regresit nga i padituri, por në rastin konkret duke iu falur besimin gjendjes faktike të konstatuar nga provat gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur duke e aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses.

Gjithashtu edhe lidhur me shpenzimet e procedurës, e njëjta vlerësoi se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë.

Gjykata e Apelit i ka vlerësuar edhe pretendimet tjera të paditëses po ka konsideruar se nuk përbëjnë bazë për të vendosur ndryshe.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.1041/18, me datë 27.12.2019

Kryetare e kolegjit,  
Frosina Sylejmani